



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-148

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBETARE MES
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN MBI
MISIONIN E BASHKIMIT EVROPIAN PËR SUNDIM TË LIGJIT NË
KOSOVË**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Duke marrë parasysh përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për avancimin e sundimit të ligjit në Kosovë, nevojën për ngritjen e kapaciteteve të tyre, gadishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me Bashkimin Evropian në këtë drejtim dhe mbështetjen e vazhdueshme të Bashkimit Evropian nëpërmjet EULEX-it për të arritur këto qëllime,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBETARE MES
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN MBI
MISIONIN E BASHKIMIT EVROPIAN PËR SUNDIM TË LIGJIT NË
KOSOVË**

Neni 1 Qëllimi

1. Ky ligj ratifikon marrëveshjen ndërkombëtare të arritur nëpërmjet shkëmbimit të instrumenteve mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (“EULEX”).

2. Ky ligj ratifikon marrëveshjen ndërkombëtare në tërësi, duke përfshirë këtu, por pa u kufizuar nga:

a) zgjatja e mandatit të EULEX-it në fushat e parapara në marrëveshje deri më 15 qershor 2014, dhe me përjashtim të Task Forcës Hulumtuese Speciale;

b) delegimi i autoritetit për propozimin dhe emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, në përputhje me Kushtetutën, neni 20, dhe krijimi i një kuadri për formimin e një sistemi të regjistrimit për stafin e EULEX-it që i lejohet armë-mbajtja; dhe

c) garantimi e imunitetit të stafit të zyrës dhe personelit të EULEX-it si dhe Përfaqësuesit Special të BE-së, (“EUSR”), në bazë të Ligjit Nr. 03/L-033 për Statusin, Imunitetet, dhe Privilegjet e Misioneve diplomatike, Konsullore dhe Personelin e Kosovës dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake si dhe Personelin e Saj.

Neni 2 Fushëveprimi

Marrëveshja ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian do të jetë pjesë përbërëse e këtij ligji (shtojca 1) dhe zbatohet nga Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian.

Neni 3 Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë pas shpalljes së tij nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-148
7 shtator 2012**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI